

V E N D I M
Nr.124, datë 15.3.2001

PËR DEKLASIFIKIMIN E ZHVLERËSIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
“SEKRET SHETETËROR”, QË NDODHET NË RRJETIN KOMBËTAR TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrjetin kombëtar të arkivave, të ngrihen Komisionet për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin (KDZH) të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili përfshihet në çfarëdo lloji fondi dokumentar.

2. Komisioni i Deklasifikimit e Zhvlerësimit përbëhet nga jo më pak se 5 persona. Kur ekziston prodhuesi i informacionit të klasifikuar, në komision merr pjesë, detyrimisht, edhe një përfaqësues i tij.

3. Titullari i institucionit, që ka në zotërim informacionin e klasifikuar, është kryetari i KDZH-së, ndërsa drejtuesi i arkivit, që administron informacionin e klasifikuar, objekt i deklasifikimit ose zhvlerësimit, është nënkryetar i këtij komisioni. Sekretar komisioni caktohet fondruajtësi i informacionit të klasifikuar.

4. KDZH-ja, për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar, zbaton kriteret e përcaktuara në nenin 13, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, si dhe listat tip, të dokumenteve “sekret shtetëror”, të institucionit prodhues të origjinës.

5. Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, që kanë hyrë në arkiva, të emërtuara “sekret shtetëror”, sipas niveleve, zbatohen kriteret dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

6. Dokumentet në ruajtje, që trashëgohen në rrjetin kombëtar të arkivave, të ardhura prej subjekteve fondkrijuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk u nënshtrohen deklasifikimit dhe zhvlerësimit deri në 150 vjet nga data e krijimit.

7. KDZH-ja merr për dokumentet që ndodhen në arkivat e sistemit, vendim për deklasifikimin ose zhvlerësimin e tyre, ndërsa kur vëren se dokumentet i përkasin institucioneve të tjera eprore, ua përcjell atyre për veprim, duke u kërkuar vendimin përkatës.

8. Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar, KDZH-ja:

a) kur ekziston prodhuesi i informacionit, merr mendimin e tij;

b) kur ekziston një organ, që ka trashëguar veprimtarinë e organit të origjinës, merr mendimin e tij;

c) kur nuk ekziston organi i origjinës (prodhuesi), zbaton nenin 23, të ligjit nr.7726, dsatë 29.6.1993, “Për fondin arkivor kombëtar dhe arkivat”, duke marrë mendimin e specializuar të një përfaqësuesi të një institucioni, fusha e veprimtarisë e të cilit është e përafërt me objektin e trajtuar nga informacioni.

9. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e tij, KDZH-ja, vendos:

a) ruajtjen e nivelit të klasifikimit, të përcaktuar në listë, sipas afatit të ruajtjes;

b) uljen e nivelit të klasifikimit, të përcaktuar në listë;

c) përjashtimin nga deklasifikimi ose zhvlerësimi, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 16, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

10. Rrjeti kombëtar i arkivave harton bibliografinë e informacionit të deklasifikuar, e cila përmban ndryshimet në statusin e këtij informacioni, që nga krijimi, zhvlerësimi, deklasifikimi, etj.

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar i vihet në dispozicion, për njohje dhe përdorim, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

11. Publiku mund të njihet me informacionin e deklasifikuar, në raste dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.7726, datë 29.6.1993, “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat.

12. Informacioni i klasifikuar, i përjashtuar nga deklasifikimi, i nënshtrohet rishikimit

sistematik të deklasifikimit, sipas procedurave të këtij vendimi.

13. Shërbimi Informativ Kombëtar, në bashkëpunim me organet e tjera informative, ka të drejtën e rekomandimit të procedurave të veçanta për deklasifikimin e informacionit, për rastet e parashikuara në ligj.

14. Ngarkohen ministritë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtuesit e këtyre institucioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, detyrohen të nxjerrin udhëzim për zbatimin e tij.

15. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta